

DEKLARATË PËR ANGAZHIM

Ne, të nënshkruarit më poshtë,

Të udhëhequr nga parimi se promovimi i barazisë gjinore si vlerë është përgjegjësi e të gjithë aktorëve në shoqëritë tona;

Duke besuar se respektimi i plotë i të drejtave të grave, si dhe përpjekjet e vazhdueshme dhe sistematike të udhëhequra nga qasja strategjike ndaj barazisë gjinore janë parakusht kryesor për zhvillim ekonomik dhe social;

Duke e përshëndetur progresin në zhvillimin e kornizës juridike dhe politike, por njëkohësisht duhe e nxjerrë në pah/dukje zbatimin e pamjaftueshëm dhe joefektiv të ligjeve dhe politikës si përgjigje të disa sfidave kryesore të barazisë gjinore që ekzistojnë në vendet tona;

Duke i konfirmuar përfitimet/dobitë dhe efektet e dukshme të mbështetjes reciproke, shkëmbimit të informacioneve dhe lidhjeve të krijuara nga projekti "Barazia dhe Përfaqësimi Gjinor Përtej Kufijve" të mbështetura nga BE në kuadër të IPA instrumentit për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës.

E deklarojmë angazhimin tonë

Për vazhdimin e bashkëpunimit ndërkufitar nëpërmjet vendosjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të një rrjeti bashkëpunues joformal të bazuar në solidaritet, vlerësim dhe respektim të barabartë të të gjitha organizatave pjesëmarrëse.

Për shkëmbim të informacioneve dhe resurseve si dhe ndërmarrje të inisiativave të përbashkëta që synojnë:

- Mbështetjen e pjesëmarrjes influencuese qytetare të grave në proceset e vendimmarrjes;
- Ndryshimin e vlerave partiarkale dhe roleve tradicionale të grave ekskluzivisht si nëna dhe amvise, të cilat e kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në jetën shoqërore, politike dhe ekonomike të bashkësisë lokale;
- Përfaqësim/avokim për përmirësimin e infrastrukturës bazë dhe shërbimeve sociale dhe atyre shëndetësore të cilat e mbingarkojnë përditshmërinë e grave, veçanërisht në zonat rurale dhe pengojnë realizimin e interesave të tyre ekonomike, sociale, politike si dhe të interesave të tjera.
- Përfaqësim/avokim për politika për punësim të cilat do të sigurojnë kapërcimin e pabarazisë ekonomike të grave, pabarazi që ekziston dhe manifestohet nëpërmjet shkallës së lartë të pasivitetit ekonomik, qasjes së kufizuar ndaj vendeve të mira/të denja të punës, pabarazisë në të ardhurat si dhe varfërisë në punësim;
- Përfaqësim/avokim për politikë efektive dhe përgjigje institucionale të formave të ndryshme të diskriminimit dhe dhunës mbi gratë në jetën publike dhe private, forma shumë të pranishme dhe gjerësisht të përhapura;
- Përfaqësim/avokim për shpërndarje korrekte, të drejtë të resurseve publike, duke përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të grave dhe arritjen/realizimin e barazisë gjinore.

Në Shkup, 22.11.2016

Organizata nënshkruese:

